

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MAG IDROENERGY” Sh.p.k.

Sot, me date 11 Qershor 2018 (dymije e tetembehjete), Shoqeria “Mecamidi Italia” SRL, shoqeri e se drejtes Italiane, me seli ne CUNEO – Via Bartolomeo Bruni, no.7, e regjistruar ne regjistrin e shoqerive ne Cuneo me numer 0304550049, e perfaqesuar ne kete akt nga Z. Luc Marcy, shtetas francez, lindur ne me 07.04.1951, ne Carpentras, France dhe banues ne 57, Rue Portail Magnanen, 84000, Avignon, France, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me numer 16CC91271, e vlefshme deri me 24.07.2026, perdorues i cel: 0033607533978 dhe e-mail: luc.marcy@mecamidi-italia.com.

Neni 1

Themelohet shoqeria tregtare: “**Mag Idroenergy**” Sh.p.k.
Shoqeria tregtare: “**Mag Idroenergy**” do te jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
Ortaku themelues i shoqerise eshte “**Mecamidi Italia**” Srl
Emertimi i shoqerise do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

Neni 2

Selia e Shoqerise eshte: Tirane, Rruga “Rreshit Collaku”, pallati i ri, hyrja nr. 1, kat.2, Ap.1, Tirane.

Neni 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise si edhe jashte saj, konform legjislacionit ne fuqi. Me vendimin e ortakeve, mund te krijohen ose anulohen (nese jane celur) seli, filiale, agjensi, dhe perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise ashtu edhe jashte saj.

Njesite e tjera strukture te shoqerise si dege apo perfaqesi jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve te huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, formuar nga ortaket themelues, i ndare ne 1 (nje) kuote, zoteruar si vijon:
Shoqeria “**Mecamidi Italia**” S.r.l.zoteron nje kuote, respektivisht 100% (njeqind per qind) te kapitalit te shoqerise.

Shoqeria mund te ndryshoje kapitalin themeltar, transferimi i kuotave kuhstozohet nga e drejta e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere.
Po keshtu transferimi i kuotave behet sipas neneve 72,73,74 e 75 dhe pergjithesisht sic parashikohet ne ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i



ndryshuar. Te gjitha transferimet kane efekt mbi shoqerine qe nga momenti i regjistrimit ne librin e Ortakeve.

Ortaket kane te drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter te fituar ne rruge te ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

Neni 5

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise eshte me nje afat te pacaktuar.

Neni 6

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj tregtar ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akt themelimi dhe Statutit te saj.

Neni 7

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne perputhje me ligjin dhe statutin.

Neni 8

Shoqeria «MAG Idroenergy » sh.p.k. krijohet per te ushturaraktivitetin e saj conform objektit qe do te jete : *Kerkimi, zhvillimi, krijimi, konsulenca, projektimi, ndertimi, riparimi, ndryshimi, shitja shperndarja, instalimi, agjenci dhe/ose perfaqesi tregtare, ndihme dhe administrim te impianteve dhe/ose njesi te vecanta per prodhimin e energjise hidro-elektrike dhe burime te tjera te rigjenerueshme. Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet tregtare, industriale, mobiliare dhe imobiliare qe shihen te arsyeshme dhe te nevojshme per permbushjen e objektit te shoqerise duke marre garanci reale dhe personale dhe me favor te te treteve dhe per te marre pjesemarrjet e interesat ne shoqeri te tjera, me kushtin qe keto veprimtari te mos zhvillohen kunder publikut apo pertej limiteve te dispozitave ligjore.*


Neni 9

Me vendimte Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund te zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtimet e tjera te cilat jane me interes per mbarevajtjen e shoqerise.

Neni 10

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqiptar apo te huaj, ose te bashkohet me shoqeri tjeter tregtare si Brenda ashtu dhe jashte vendit.

Neni 11



Asambleja e pergjithshme e Ortakeve eshte organi me I larte Drejtues dhe vendimmarres I shoqerise dhe ushtron kompetencat qe ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, i njeh asamblese se ortakeve qe jane krijuar me ortakeri.

Ortaket mund t'ia delegojne kompetencat nje ose me shume administratoreve te caktuar prej tyre ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise.

Neni 12

Administrimi I shoqërisë bëhet nga Administratorët bashkerisht që është një organ I përbërë nga dy persona fizik.

Administratori/et emerohet ne kete detyre per nje afat kohor 5 (pese) vjecar duke nisur nga dita e nënshkrimit të këtij akt themelimi.

Administrimi i shoqërisë "Mag Idroenergy" Sh.p.k i besohet administratoreve si me poshte:

1. Z. Luc Marcy, shtetas francez, lindur ne me 07.04.1951, ne Carpentras, France dhe banues ne 57, Rue Portail Magnanen, 84000, Avignon, France, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me numer 16CC91271, e vlefshme deri me 24.07.2026, perdorues i cel: 0033607533978 dhe e-mail: luc.marcy@mecamidi-italia.com,
2. Z. Francesco Ghisoli, shtetas Italian, i lindur me 31.05.1972, ne Ottaviano, Itali, dhe banues ne Pianfei, Via Bisalta no. 8, Itali, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, dhe mbajtes i kartes se identitetit me numer personal AT8751385, e vlefshme deri me 31.05.2024, perdorues i cel: 00393482305133 dhe e-mail: f.ghisoli@mecamidi-italia.com

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE TREGTARE

Shoqeria "MECAMIDI ITALIA" SRL

Perfaqesuar nga

Luc Marcy

